



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 650/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 10.10.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Zeqiri” sh.p.k., “Euro Inform” sh.p.k. dhe “Fastech” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-22199-05-15-2019, me objekt “Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike”, me fond limit 8.302.109 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier”.

**Ankimues:** “PC Store” sh.p.k.  
Rruga e Dibrës, Vila 154, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier  
Lagjia “Kastriot” Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr. 15, Fier

**Subjekte të Interesuara:** “Zeqiri” sh.p.k.  
Lagjia Bishanak, Rruga Skënderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private , Pasuria nr. 1/1088, Kati I—rë, Fier

“Euro Inform” sh.p.k.  
Rruga Ndreko Rino, Nd. 1, H. 15, Kodi postar 1019, Tiranë

“Fastech” sh.p.k.

Njësia Bashkiake nr 5, Rruga “Brigada VIII”, Ndërtesa 8, hyrja 6, ap 1,  
Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

## *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-22199-05-15-2019, me objekt “*Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike*”, me fond limit 8.302.109 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier”.

II.2. Në datën 10.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

|    |                           |                             |
|----|---------------------------|-----------------------------|
| 1. | “Zeqiri” sh.p.k.          | 6.050.000 lekë, kualifikuar |
| 2. | “Euro Inform” sh.p.k.     | 6.650.370 lekë, kualifikuar |
| 3. | “Fastech” sh.p.k.         | 7.311.400 lekë, kualifikuar |
| 4. | “PC Store” sh.p.k.        | 7.320.950 lekë, kualifikuar |
| 5. | “2RC” sh.p.k.             | 7.398.935 lekë, kualifikuar |
| 6. | “BNT Electronics” sh.p.k. | 7.587.570 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 13.06.2019 operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 18.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Zeqiri” sh.p.k., “Euro Inform” sh.p.k. dhe “Fastech” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se: [...] *Për shkeljet ligjore nga AK-ja të: Referojmë Neni 1 i LPP-së [...]*  
*Neni 27 dhe Neni 66 të VKM-së Rrpp-së [...]*

*Neni 4; Neni 11; neni 12; neni 13; neni 14; neni 17; i Ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të R.SH. në fuqi.*

*Me datën 10 Qershor 2019, OE "PC STORE" sh.p.k, ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me mjete elektronike të zhvilluar nga ana Juaj si Autoritet Kontraktor- Bashkia Fier, me objekt "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike", me Nr. REF-22199-05-15-2019, me fond limit 8 302 109 leke pa TVSH. Me datë 13 Qershor 2019, në llogarinë tonë të mesazheve në SPE, nga AK ka ardhur njoftimi elektronik me subjekt: Vleresimet për tenderin "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike" (Faza e vleresimit të tenderit), ku njoftohet se ofertat janë kualifikuar dhe suksesshme.*

*Njehkohet me këtë njoftim vërejtje kualifikimin të suksesshem të tre operatorëve të tjerë. konkretisht OE "ZEQIRI" shpk, "EURO INFORM" shpk dhe "FASTECH" shpk.*

Nepermjet pikes II të trajtuar me poshte, Ju paraqesim argumentet e ankeses, per kundershhtimin e refuzimit të ofertës tone nga AK.

II. (Argumentet e ankeses se OE "PC STORE" shpk, të paraqitur pranë AK per kundershhtimin e kualifikimin të OE "ZEQIRI" shpk, "EURO INFORM" shpk dhe "FASTECH" shpk.)

Theksojme se ky kualifikim i OE "ZEQIRI" shpk, "EURO INFORM" shpk dhe "FASTECH" shpk, është një vendim i Autoritetit Kontraktor, i marre ne kundershhtim me ligjin e prokurimit publik ne fuqi. Ky vendim i AK per kualifikimin e tyre, është bazuar ne një proces të pa rregullt të shqyrtimit të ofertave, të pa bazuar ne kriteret dhe kerkesat e kualifikimit, specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, si dhe pergjigjen e kerkeses per sqarirn.

Ky vendim i AK per kualifikimin e ofertuesve qe nuk zoterojne kerkesat e kualifikimit, demton interesin e ligjshem të OE "PC STORE" shpk, si dhe e vendos kete të fundit ne një pozite të pabarabarte dhe diskriminuese. AK ka vepruar duke shkelur parimin per barazi të trajtimit e kerkesave dhe të detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidatave.

Bazuar ne pikenv 1 dhe 2, të Nenit 63 të Ligjit "Per Prokurimin Publik" të ndryshuar paraqesim argumentat dhe faktet per secilin prej OE-ve, si me poshte:

Ankesa 1

Ne lidhje me kualifikimin e OE "ZEQIRI" shpk, bejme me dije se:

A. Ne nenpiken 2.3.4, të pikes "2.3 Kapaciteti teknik ", te kriterëve të vecanta. të

Dokumenteve të Tenderit, kerkohet:

2.3.4. Pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara)

Si pajisje kompjuterike të kerkuara ne tender, jane:

| NR | Emertimi I Pajisjes           | Sasia/cope |
|----|-------------------------------|------------|
| 1  | UPS 1000VA                    | 45         |
| 2  | UPS 2000VA                    | 1          |
| 3  | Kompjuetr Desktop 1           | 41         |
| 4  | Kompjuter Desktop 2           | 4          |
| 5  | Monitor Led 21" Brand         | 5          |
| 6  | Printer All in One B&E        | 27         |
| 7  | Printer Color                 | 1          |
| 8  | Hard Drive HDD External Brand | 10         |

|    |   |     |
|----|---|-----|
| 9  | <i>Tastiera</i>                                     | 30  |
| 10 | <i>Mouse</i>  | 50  |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>                           | 4   |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                                 | 1   |
| 13 | <i>Bllok ushqimi 650Ë</i>                           | 2   |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                              | 3   |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                                   | 4   |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                                   | 4   |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>                          | 1   |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>                         | 1   |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i>             | 2   |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                                 | 2   |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>                   | 200 |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>                    | 150 |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                                | 1   |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                               | 1   |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>                 | 1   |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>                   | 1   |
| 27 | <i>Psjisje Rregjistrimi LIVE</i>                    | 1   |
| 28 | <i>Sëitche</i>                                      | 11  |
| 29 | <i>Printer B&amp;Ë Advanced</i>                     | 4   |
| 30 | <i>Fotokopje Multifunx B&amp; Ë Basic</i>           | 1   |
| 31 | <i>Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine</i> | 1   |
| 32 | <i>Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced</i>       | 1   |

*Sa me siper ju bejme one dije se OE "ZEQIRI" shpk nuk ka paraqitur kataloge të noterizuar, të perkthyer per zerat e kerkuar.*

*Praktikisht,*

*OE "ZEQIRI" shpk, nuk ka paraqitur pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen, si: UPS 1000VA, UPS 2000VA, Kompjuetr Desktop 1; Kompjiter Desktop 2, Monitor Led 21 " Brand, Printer All in One B&Ë, Printer Color, Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme. Bllok ushqimi 6-55Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB HDMI, Kabuli Rijeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rijeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE, Sëitche, Printer B&Ë Advanced, Fotokopje Multifimx B&Ë Basic, Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine, Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced.*

*OE "ZEQIRI" shpk, nuk ka paraqitur të perkthyer specifikimet teknike per: UPS 1000VA, UPS 2000VA, Kompjuetr Desktop 1, Kompjuter Desktop 2, Monitor Led 21" Brand, Printer All in One B&Ë, Printer Color, Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushqimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabuli Rrjeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rrjeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rijeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Paisje Rregjistrimi LIVE, Sëitche, Printer B&Ë Advanced, Fotokopje Multifunx B&Ë Basic, Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine, Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced*

*OE "ZEQIRI" shpk, nuk ka paraqitur të noterizuara specifikimet teknike per: UPS 1000VA, UPS 2000VA, Kompjuetr Desktop 1, Kompjuter Desktop 2, Monitor Led 21" Brand, Printer All in One B&Ë, Printer Color, Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushqimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabuli Rrjeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rijeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE, Sëitche, Printer B&Ë Advanced, Fotokopje Multifunx B&Ë Basic, Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine, Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced.*

*OE ZEQIRI shpk nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme me natyren dhe zerat e objektit të prokurimit.*

*OE ZEQIRI shpk nuk ka paraqitur Certifikate të menaxhimit to cilesise ISO 9001 : 2015 per objektin e prokurimit (e cilat duhet të jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuara).*

*Ky OE nuk zoteron nje certifikate të tille per tregetimin e pajisjeve elektronike, si dhe instalimin konfigurimin e tyre.*

*Ky OE nuk ka paraqitur certifikate ISO 9001: 2015 të noterizuar. Pajisjet e ofruara nga OE ZEQIRI shpk nuk plotesojne kerkesat teknike të kerkuara nga AK.*

*E. Ne pergjigjen e kerkeses per sqarim, të kesaj procedure prokurimi, nga AK kerkohet:*

*Per zërin 27 "Pajisje Rregjistrimi Live", nga OE kërkohej të dihet nëse AK kërkon vetëm dorëzimin e saj apo kërkohej edhe instalimi-konfigurimi e integrimi?*

*AK ju ben me dije se: "Per kete pajisje kërkohej të jete i perfshire instalimi dhe konfigurimi i pajisjes one pajisje të tjera si mikrofon,kompjuter dhe aparat fotografik" dhe keto konfigurime sikurse e shprehni edhe ju kërkojne nje specialist të kualifikuar e të certifikuar.*

*Sa me siper ju bejme me dije se OE "ZEQIRI" shpk nuk ka marre persiper instalimin dhe konfigurimin e pajisjes se rregjistrimit Live. KY OE as nuk ka specialiste per të tilla instalime.*

*OE "ZEQIRI" shpk, sipas Ekstraktit të QKB, ne objektin e tij të aktivitetit tregëtar, merr persiper të realizoj: Germime dheu, murature dhe betonarme Prodhime materiale inerte-gur*

*Prodhim elemente betoni e betonarme to zakonshme-paranderur-gur dekorativ, Prodhim materiale me baze biturni sintetik,*

*Ndertime civile-inustriale-turistik bujqesore deri ne pese kate. Ndertim rruge*

*Punime hekurudhore, Ndertime tunele,*

*Punime me lende plasese dhe shperthyese,*

*ndertim autostrada,pista,aeroporte,helioporte*

*Ndertim impiante të trajtim të ujit,ndertim vajisjelles,gazsjelles,naftesjelles,diga,damba, Puse-shpime, Lojra fati.*

*Tregtim karburante e vajra lubrifikante Bar-restorant*

*Import-ekport automjete të të gjitha llojeve,*

*Terhegje dhe eliminimi i mbetjeve spitalore,*

*operatore per hedhjen e të dhenave ne kompjuter,*

*Sherbimi i Pastrimit të ambienteve shteterore e private , kiyeiye e sherbimit 3 D per spitale , çerdhe e kopshte , klinike dentare dhe import të materialeve dentare dhe tregtimin e tyre,*

*tregti me pakice dhe shumice i artikujve të ndrysherm industriale, ushqimore, fruta, perime dhe i atyre me origjine shtazore,*

*Tregtim i pajisjeve elektronike dhe pjeseve të tyre. Dizajn, zhvillim dhe tregtim i faqeve ëeb dhe programeve kompjuterike. Tregtimi dhe perpunimi i strukturave metalike. Tregtimi dhe perpunimi i materialeve të buta.*

*Pe pak fjale, pa e paragjykuar por ky OE i ben të gjitha, me sakt kap cfar ti dali, nga shperthimet dhe lojrat e fatit deri ne hekurudha, gazsjellesa, aeroporte, deratizime, fruta perime dhe artikuj si gjiza dhe gjalpi.*

*Pavaresisht kesaj, gje qe ligjerisht per objektin tregëtar nuk kemi asnje pretendim, i theksojme AK-se se ketij OE i mungojne specialistet e certifikuar nga prodhuesit perkates, per montim, instalim dhe konfigurim të pajisjeve objekt kontrate, sic eshte kerkuar nga AK të pergjigja e kerkeses per sqarim.*

*Ne pergjigjen ndaj kerkeses per sqarim, AK percakton:*

*Per keto pajisje duke qene se jane pajisje specifike dhe tq brandeve tq papercaktuar AK kërkon instalimin /konfigurimin e pajisjeve si dhe support të vazhdueshern per periudhen e mbulimit të garancisë. AK shprehet se per pajisjet e inesiperme montimi dhe konfigurimi dë të realizohet nga nje specialist i certifikuar (nga brand-i perkates) per pajisjen konkrete (pshfotokopje). Ky specialist do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues ne momentin e levrimit të mallit të kerkuar apo venien ne funksionim të tij.*

*I kujtojme AK, se ne Dokumentet e Tenderit, konkretisht ne piken 2.14 dhe 2.14.1, të Seksionit 2 "Objekti i kontrates", të Njoftimit të Kontrates, eshte percaktuar se nga AK nuk do të pranohen variantet dhe nuk do të pranohet nenkontraktimi.*

*Kjo do to thote se ofertuesi duhet ti realizoje instalimet e konfigurimet e kerkuara, me kapacitetet e veta. Kapacitete të tilla të cilat ky operator nuk i ka.*

*Ose ne to kundert AK do to lejoje nenkontraktimin, qe ne kete rast eshte i ndaluar, ne kundershtrim me percaktimet e rregullave të konkurimit ne DT, e per rrjedhoje i paligjshem.*

*Nje kualifikim i ketij OE, ne keto kushte, me keto mangesi ne oferte dhe kapacitete teknike e profesionale, perben haptazi trajtim të pabarabarte të ofertuesve. AK ka nxjerre nje vendim, pas nje procesi shqyrtimi të ofertave, pa barazi ne trajtimin e kerkesave dhe të detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Pra, praktikisht, AK pasi ka caktuar ne DT kushtet dhe kriteret qe duhet të plotesojne operatoret ofertues per të qene të suksesshem, me pas i ka shkelur vete ato ne fazen e vleresimit të ofertave, duke mos i marre ne konsiderate e duke vepruar keshtu ne kundershtrim me nenin 53 to LPP.*

*Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve" i LPP ne fuqi, ne piken 1 referojmë[...]*

*Neni 2 i LPP-së [.....]*

*Neni 20 i LPP-së[...]*

*Gjithashtu vendimi i Ak-së është marrë në kundërshtim me:*

*Neni 53 dhe neni 55 të cilët i referojmë[...]*

*Sa me siper, AK ka kualifikuar te vlefshme oferten e OE Zeqiri shpk, ne kundershtrim me nenin 46 to LPP, pasi pasi ky OE nuk ka permbushur të gjitha kriteret e kualifikimit, qe autoriteti kontraktor i ka vleresuar të nevojshme. Kjo e ben kete vleresim to pavlefshem e të pa ligjshem, konkretisht ne kundershtrim me dispozitat ligjore si me poshte:*

*AK ka kualifikuar të vlefshme oferten e OE Zeqiri shpk, ne kundeshtrim me nenin 2 të LPP, pasi AK nuk ka trajtuar me barazi dhe paanshrneri operatoret ekonomik pjesemarres, ne procesin e vleresimit të ofertave.*

*AK, ka kerkuar ne DT, qe OE-te per të kualifikuar duhet të paraqesin pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara), pas kesaj, ne procesin e shqyrtimit të ofertave AK nuk e ka marre ne konsiderate kete kusht dhe i ka kualifikuar si te suksesshem të gjithë operatoret ekonomik edhe pse jo të gjithë i plotesojne kushtet e AK.*

*Me kete proces të pa rregullt të shqyrtimit të ofertave, AK ka nxitur konkurencen e pandershme, ku nje OE duhet të plotesojne kushtet e kualifikimit qe të shpallet i suksesshem, e nje OE tjeter shpallet i suksesshem edhe pse nuk i ploteson ato.*

*Ky eshte haptazi nje diskriminim ne procedure. Eshte nje trajtim diskriminues midis OE-ve, i ndaluar me nenin 20 to LPP.*

*Vleresimi i AK eshte absurd pasi e bazon garen vetem ne cmimin me të ulet, nderkohe qe LPP thot Neni 55, pika 1. Oferta fituese duhet të jete: a) oferta qe ne baze të kerkesave dhe kriterëve të percaktuara ne dokumentet e tenderit.ploteson kerkesat e objektit të prokurimit me cmimin me të ulet. Pra me pare OE-te duhet të plotesojne kushtet e kualifikimit, e me pas midis OE-ve qe i plotesojne, do të shpallet fitues ajo qe ka cmimin me te ulet. Dhe ne keto kushte, OE Zeqiri nuk i ploteson kriteret e kualifikimit të DT, e*



per rrjedhoje oferta financiare e tij nuk duhet te krahasohet me ato te ofertuesve te sukseshem, si dhe nuk mund te jete fitues ne kete procedure prokurimi.

Sipas nenit 53 pika 3, të LPP, AK e vlereson nje oferte të vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me të gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Ne rastin konkret oferta e OE Zegiri, eshte vleresuar e vlefshme ne kundershtim me nenin 53 to LPP. AK e ka vleresuar të vlefshem oferten e OE ZEQIRI edhe pse ajo nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DST dhe shkreses per sqarim. Ky eshte nje kualifikim i pa ligjshem, nje akt administrativ i pa ligjshem.

Sipas nenit 55 pika 2, të LPP, AK e vlereson nje oferte të vlefshme, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit, dhe nuk duhet të perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit. AK nuk ka respektuar kete dispozite, gjithashtu AK ka perdorur kriteret të tjera qe nuk jane të parashikuara ne DT por qe jane lejuese per oferten e OE ZEQIRI shpk. Ne si OE duhet të ishim njohur me pare me keto kriteret lejuese, qe lejojne ofertuesit qe nuk permbushin kriteret e kualifikimit, të konsiderohen të sukseshem. Kjo ka sjelle nje vendim të pa ligjshem te AK. nje akt administrativ te pa ligjshem. AK, eshte gjithashtu haptazi promovuese dhe nxitese e kufizimit të konkurrences dhe shkeljes se ligjit per mbrojtjen e konkurrences.

Ne Nenin 4 "Marreveshjet e ndaluara" të Ligji Nr. 9121, date 28.7.2003 "PER MBROJTJEN E KONKURRENCES" të ndryshuar, gjejme refrojmë[...]

Pra, ne kundershtim me kete ligj, AK nxit dhe lejon pengimin, kufizimin ose shtremberimin e konkurrences në treg. AK gjate procesit të konkurimit, ndryshon dhe cakton kushte te tjera tregetimi. AK, zbaton kushte te ndryshme per rregulla të njejta, duke i vendosur OE-te tie gjendje të pafavorshme konkurrence. Veprimet per nxjerrjen e nje akti administrativ të paligjshem (sipas Nenit 109 të kodit të procedurave administrative), bien ndesh dhe ngarkojne me pergjegjesi AK-ne sipas Nenit 4 "parimi i ligjshmerise". Neni 5 "parimi i transparences", Neni I "parimi i ushtrimit të diskrecionit te ligjshem", Neni 13 "parimi i drejtesise dhe paanshmerise", Neni 14 "parimi i objektivitetit". Neni 15 "parimi i pergjegjesise" dhe Neni 17 "parimi i barazise dhe i mosdiskriminimit", te Kodit te Procedurave Administrative ne fuqi.

Neni 109 "Paligjshmeria e aktit administrativ" i Kodit te Procedurave Administrative ne fuqi, parashikon:referojmë[...]

Pra, paligjshmeria e aktit administrativ sipas pikes "b" dhe "d" eshte lehtesisht e kuptueshme, ndersa per piken "c" dhe "dh" shpjegojme si me poshte:

Per piken "dh":

Neni 11 i K.Pr.A., Parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit,

Diskrecioni ushtrohet ligjerisht kur ai eshte ne perputhje me kushtet e meposhtme:

a) eshte i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijte e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik eshte bere vetem per te arritur objektivin per te cilin eshte lejuar diskrecioni dhe eshte ne perputhje me parimet e pergjithshme te ketij Kodi; dhe;

c) zgjedhja nuk perben nje shmangje te pajustificuar nga vendimet e meparshme të mama nga i njejti organ tie raste të njejta apo të ngjashme.

*Termi diskrecion eshte i perkufizuar në Nenin 3, të Kodit të Procedurave Administrative, referojmë[...]  
Per sa dikton ky parim dhe LPP, kualifikimi dhe shpallja fitues i nje ofertuesi, jane në vleresimin dhe zgjedhjen e AK. Kualifikimi i ofertuesit ne kushtet ku nuk ploteson kerkesat e DT, verteton shkeljen e ligjit nga ana e AK. Nder të tjera, ky vleresim i tille vjen per shkak të ushtrimit të pa drejte dhe me keqperdorim të Disskrecionit të organit publik. AK, me nje vleresim te tille të ofertave, ka ushtruar autoritetin e organit publik, ne tejkalim të kufijeve ligjore (nenit 1, 2, 20, 46, 53, 55 të LPP dhe nenit 4 të ligjit per konkurrencen), gje qe sjell mospermbushjen e nje qellimi të ligjshem.*

*Diskrecioni dikton qe, nje e drejte ose nje veprim duhet të behen dhe të ushtrohen sipas rregullave të arsyes, drejtesise, objektivitetit e paanshmerise, propocionalitetit e ne rastin konkret ne peiputhje me parimet e prokurimit publik dhe jo sipas opinionit apo interesit personal to organit. Pra, ushtrimi i nje to drejte ose kryeija e nje veprimi nuk duhet to jete arbitrar, por duhet to jete ligjore dhe to ushtrohet brenda hapesires qe i eshte dhene organit, me synim, realizimin e nje gellimi to ligjshem.*

*Sipas nenit 109 te Kodit te procedurave administrative, ne kushtet se si AK Bashkia Fier ka vepruar (sipas deshires dhe pa a bazaar ne rregullat dhe parimet e prokurimit publik), ben qe vendimi i rnarre prej AK te konsiderohet i paligjshem.*

*Ne kete rast, Ushtrimi i nje pushteti diskrecionar nga AK, duke shmangur dispozitat ligjore qe perligjin te drejtat e operatorit ekonomik per nje konkurence te hapur dhe te drejte ne tender, e vendos kete te fundit ne nje pozite te pafavorshme, te pabarabarte dhe perjashtuese, pa ndonje arsye te ligjshme. Kuptohet qe realizimi i qellimit të ligjshem, ne rastin konkret nuk eshte procesi i rregullt dhe i hapur i prokurimit, qellimi i deshiruar kuptojme se eshte realizimi i interesit personal të zyrtareve. Ushtrimi i diskrecionit nuk mund te perdoret per nje qellim të ndryshem nga qellimi i ligjit, ne të kundert konsiderohet i paligjshem. Për pikën ç:*

*Për pikën çneni 4 parimi i ligjshmerisë; pika 2 e referojmë[...]*

*Pra, sipas ketij parimi të Kodit të Procedurave Administrative, e drejta apo interesi i ligjshem i PC STORE per tu shpallur fitues ne kete procedure nuk duhet të cenohet nga veprimi administrativ i AK (kualifikimi i të gjithë oe-ve ne menyre të paligjshme). Qe keto interesa të OE PC STORE të cenohen, duhet me pare të parashikohen ne ligj dhe të behen ne rrespektim të nje procesi të rregullt ligjor. Ku ne rastin konkret, nga AK nuk kemi nje proces të rregullt ligjor të shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave, si dhe nuk eshte askund e parashikuar ne ligj qe të shpallen fitues ofertues qe nuk plotesojne kerkesat e kualifikimit dhe OE PC STORE ti cenohet kjo e drejte.*

*Pra, organi shteteror, do të konsiderohet se nuk vepron ne perputhje me kerkesat e ligjit vetem ne rastin kur ekzistojne kerkesa ligjore të percaktuara shprehimisht dhe qe organi të nxjerre akte/veprime ne kundershim me to. Ne rastin konkret kualifikimi pa të drejte, i AK, kundershon dispozitat ligjore të LPP ne fuqi. Zbatimi i parimit të ligjshmerise shfaqet edhe ne rastin kur nga mosveprimi ne perputhje me ligjin nga organet shteterore, sjell si pasoje pergjegjshmeri perpara ligjit per të gjithë punonjesit/subjektet qe kryen shkeljen. Ne rastin konkret, AK ka vepruar ne shkelje të ligjit dhe qe per pasoje zyrtaret e prokurimit kane dhe duhet të mbajne pergjegjshmerine para ligjit per shkeljen e kerkesave ligjore. Parimin e pergjegjesise, ne ligjin e prokurimit publik e gjejme të shprehur ne nenin*

*72 "Kundravajtjet administrative", ku e referojmë[....]*

*Akti i paligjshem i nxjere nga AK, do të sillte minimalisht tre efekte të pa deshiruara:*

1. hetim administrativ prane AK

2. pergjegjesine e zyrtareve prane AK

3. hapjen e nje procesi gjyqesor nga OE PC STORE kunder AK, qe lehtesisht do të sjelle të drejten (vendimin ne favor) e OE PC STORE, dhe baren e AK per të paguar kostot administrative gjyqesore dhe fitimin e munguar të PC STORE.

Nga ana tjetër, me kualifikimin e nje ofertuesi qe nuk permbush kriteret e kualifikimit të dst, kontrata qe do të lidhet do te jete ne rrezik mos realizimi. Gje qe do të sillte shperdorim të fondeve publike dhe perdorim të tyre ne menyre jo efikase dhe jo eficente, me mos respektim të germes c), të Nenit 4 "Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor", të Ligjit Nr.9936, Date 26.6.2008 Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise, i ndyshuar, parashikohet, citoj:..[ Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor jane: c) perdorinri ekonomik. eficient dhe efektiv i burimeve publike:1

Pra, kuptojme se AK vepron me standarde të dyfishta dhe arbitraritet, ne kundërshtim të plote të legjislacionit të prokurimit publik dhe Kodit të Procedurave Administrative ne R.SH., si dhe ne shkelje dhe mosrespektim të parimeve të Ligjit Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise dhe ligjin per rmbrojtjen e konkurrences.

Per kete, ne menyre të vecante i drejtohem Titullarit të AK, ne cilesine e drejtuesit të organit shteteror të rivendose ligjshmerise ne proces, duke shqyrtuar ofertat dhe duke bere nje vleresim të drejte të bazuar vetem dhe vetem ne ligj. Per kete pike, kerkojme nga AK, si me poshte:

1. Rivendosjen e ligjshmerise ne kete procedure prokurimi, faza e vleresimit të ofertave,

2. Rivleresimin dhe skualifikimin e ofertes se OE "Zeqiri" sh.p.k, pasi ky operator ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST dhe pergjigjen per sqarim.

## Ankesa 2

Ne lidhje me kualifikimin e OE "EURO INFORM" shpk, bejme me dije se:

A. Ne nenpiken 2.3.4, to pikes "2.3 Kapaciteti teknik", të kriterëve të vecanta, të Dokumentëve të Tenderit, kerkohet:

2.3.4. Pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara)

Si pajisje kompjuterike të kerkuara ne tender, jane:

| NR | Emertimi I Pajisjes | Sasia/cope |
|----|---------------------|------------|
| 1  | UPS 1000VA          | 45         |
| 2  | UPS 2000VA          | 1          |
| 3  | Kompjuetr Desktop 1 | 41         |

|    |   |     |
|----|---|-----|
| 4  | <i>Kompjuter Desktop 2</i>              | 4   |
| 5  | <i>Monitor Led 21" Brand</i>            | 5   |
| 6  | <i>Printer All in One B&amp;E</i>       | 27  |
| 7  | <i>Printer Color</i>                    | 1   |
| 8  | <i>Hard Drive HDD External Brand</i>    | 10  |
| 9  | <i>Tastiera</i>                         | 30  |
| 10 | <i>Mouse</i>                            | 50  |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>               | 4   |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                     | 1   |
| 13 | <i>Bllok ushqimi 650E</i>               | 2   |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                  | 3   |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                       | 4   |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                       | 4   |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>              | 1   |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>             | 1   |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i> | 2   |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                     | 2   |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>       | 200 |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>        | 150 |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                    | 1   |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                   | 1   |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>     | 1   |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>       | 1   |
| 27 | <i>Psjisje Rregjistrimi LIVE</i>        | 1   |

|    |   |           |
|----|---|-----------|
| 28 | <i>Sëitche</i>                                      | <i>11</i> |
| 29 | <i>Printer B&amp;Ë Advanced</i>                     | <i>4</i>  |
| 30 | <i>Fotokopje Multifunx B&amp; Ë Basic</i>           | <i>1</i>  |
| 31 | <i>Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine</i> | <i>1</i>  |
| 32 | <i>Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced</i>       | <i>1</i>  |

*Për këtë ju bëjmë me dije se OE "EURO INFORM" shpk nuk ka paraqitur kataloge te noterizuar, te perkthyer, per zerat si me poshte:*

|    |   |
|----|---|
| 8  | <i>Hard Drive HDD External Brand</i>    |
| 9  | <i>Tastiera</i>                         |
| 10 | <i>Mouse</i>                            |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>               |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                     |
| 13 | <i>Bllok ushqimi 650Ë</i>               |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                  |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                       |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                       |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>              |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>             |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i> |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                     |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>       |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>        |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                    |

|    |                              |
|----|------------------------------|
| 24 | Testues Rrjeti               |
| 25 | Set Kacavid-ash Profesionale |
| 26 | Pinca prerese Profesionale   |
| 27 | Psjisje Rregjistrimi LIVE    |

*Praktikisht,*

*o OE "EURO INFORM" shpk, nuk ka paraqitur pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen, si: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushgimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabul] Rrjeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rrjeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rrjeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE.*

- OE "EURO INFORM" shpk, nuk ka paraqitur të perkthyer specifikimet teknike per: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushqirni 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabuli Rrjeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rrjeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE.*

- OE "EURO INFORM" shpk, nuk ka paraqitur të noterizuara specifikimet teknike per: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushgimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabuli Rrjeti Cat 5e(lkuti 305m), Karte Rrjeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rrjeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE.*

*B. OE EURO INFORM shpk, ka ofertuar pajisje të cilat kane mangesi dhe nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike të kerkuara nga AK.*

*Praktikisht:*

*1. Kompiuter Desktop 1 (zeri 3 ):*

- Eshte kerkuar: DVD-RË*

*Produkti i ofertuar nga EURO INFORM, ka DVD-ROM*

- *Eshte kerkuar: minimumi 3 PCI/PCI-E*

*Produkti i ofertuar nga EURO INFORM, ka 2 PCI-E*

*Eshte kerkuar: 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port*

*Produkti i ofertuar nga EURO INFORM, nuk e ka kete porte.*

## *2.Pajisje Rregjistrimi Live (zeri 27):*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK te krahasoje specifikiranet teknike te kerkuara me specifikiranet e produktit te ofertuar, qe te plotesoje specifikimet:*

*Ekрани*

*Regjistrimi*

*Integrated/Integruar 17" / 43 cm 1920 x 1200 LED-backlit LCD*

*-20 hours at 1080i using 1 TB built-in hard drive set te record at 100 Mbps AVI MJPEG*

*CPU*

*RAM*

*Memoria Karta GrafikeSix-Core processor 3.4 GHz 12 MB L3 cache, 130 16 GB 4 total DDR3 1600 MHz RAM (non-ECC)*

*(4 GB x 4 DIMM triple-channel configuration)*

*1 TB, 7200 RPM SATA 2.5" internal hard drive*

*CUDA Cores: 48, Graphics Clock (MHz): 810 MHz, Processor Clock (MHz): 1620, Memory Clock (MHz): 900 (DDR3), Standard Memory Config: 1 GB (DDR3), Memory Interface 64-bit, Memory Bandwidth (GB/sec): 14.4, Standard Display Connectors: Dual Link DVI-I, HDMI, VGA*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

## *3.Karte Grafike (zeri 23)*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK te krahasoje specifikimet teknike te kerkuara me specifikimet e produktit te ofertuar, qe te plotesoje specifikimet:*

*Minimumi Pass Mark Points: 5500 pike*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

## *4.Testues Rrjeti (zeri 24)*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK te krahasoje specifikimet teknike te kerkuara me specifikimet e produktit te ofertuar, qe te plotesoje specifikimet:*

*Testues Rrjeti  
Modeli I Cabllit  
Te testoje gjatesi kabili*

*RJ45,10Base2/BNC,RJI I,USB and Fire äare Cable Per Kabull CATS Cat 6 dhe lidhjet ISDN  
Der] ne 180m (600ft)*

- -

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

*5.Fotokopie Multifunkionale Color MPF Advanced (zeri 32)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

----- - --

*Formati Maksimal i Letres "Media A3*

*Memorja "Memory": > 2 GB*

*"Hard Disk": - ----- - - > 250 GBShpejtesia a Skanimi "Scan Speed": > 45  
ppm*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

*6 Fotokopie Multifunkionale High Volume Copy Machine (zeri 31)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK to krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Formati i Letres "Media Sizes": A3/A4*

*Memorja "Memory": > 2 GB*

*"Hard Disk": > 250 GB*

*Shpejtesia e Skanimi "Scan Speed": > 55 ppm*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

*7. Printer B&Ë Advanced (zeri 29)*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality": 1200x1200 dpi*

*Kapaciteti ne Hyrje "Input Capacity"500 Flete*

*Memorja "Memory": 256 MB*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

*8. Bllok Ushqimi 650Ë (zeri. 13)*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Poëer Supply 650ë*

*Daljet 4 dalje sata*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

*9. MONITOR 21"LED BRAND (zeri 13)*



2 dalje

Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK to krahasoje specifikimet teknike to kerkuara me specifikimet e produktit to ofertuar, qe to plotesoje specifikimet:

Koha e Rifreskimit "Response Time": 5 ms

Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.

C. Ne pergjigjen e kerkeses per sqarim, të kesaj procedure prokurinni, nga AK kerkohet:

Per zerin 27 "Pajisje Rregjistrimi Live", nga OE kerkohet të dihet nese AK kerkon vetem dorezimin e saj apo kerkohet edhe instalimi-konfigurimi e integrimi?

AK ju ben me dije se: "Per kete pajisje kerkohet të jete i pefshire instalimi dhe konfigurimi i pajisjes me pajisje të tjera si mikrofon, kompjuter dhe aparat fotografik" dhe keto konfigurime sikurse e shprehni edhe ju kerkojne nje specialist të kualifikuar e të certifikuar.

Sa me siper ju bejme me dije se OE "EURO INFORM" shpk nuk ka marre persiper instalimin dhe konfigurimin e pajisjes se rregjistrimit Live. KY OE as nuk ka specialiste per të tilla instalime.

Ne pergjigjen ndaj kerkeses per sqarim, AK percakton:

Per keto pajisje duke qene se jane pajisje specifike dhe te brandeve të papercaktuar AK kerkon instalimin /konfigurimin e pajisjeve. Si dhe support të vazhdueshem per periudhen e mbulimit të garancise AK shprehet se per pajisjet e mesiperme montimi dhe konfigurirni do të realizohet nga nje specialist i certifikuar (nga brand-i perkates) per pajisjen konkrete (pshfotokopje). Ky specialist do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues ne mornentim e levrimit të rnallit të kerkuar apo venien ne funksionirrr te tij.

Sa me siper, OE "EURO INFORM" shpk nuk ka stafin e kerkuar dhe nuk ploteson kapacitetin teknik e profesional. I kujtojme AK, se ne Dokumentet e Tenderit, konkretisht ne piken 2.14 dhe 2.14.1, të Seksionit 2 "Objekti i kontrates", të Njoftimit të Kontrates, eshte percaktuar se nga AK nuk do to pranohen variantet dhe nuk do të pranohet nenkontraktimi.

Kjo do to thote se ofertuesi duhet ti realizoje instalimet e konfigurimet e kerkuara, me kapacitetet e veta. Kapacitete të tilla të cilat ky operator nuk i ka.

Ose ne të kundert AK do të lejoje nenkontraktimin, qe ne kete rast eshte i ndaluar, ne kundershtrim me percaktimet e rregullave të konkurimit ne DT, e per rrjedhoje i paligjshem.

Nje kualifikim i ketij OE, ne keto kushte, me keto mangesi ne oferte dhe kapacitete teknike e profesionale, perben haptazi trajtim të pabarabarte të ofertuesve. AK ka nxjerre nje vendim, pas nje procesi shqyrtimi të ofertave, pa barazi ne trajtimin e kerkesave dhe të detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve. Kjo e ben kete vleresim të pavlefshem e të pa ligjshem, konkretisht ne kundershtrim me dispozitat ligjore si me poshte:

Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve" i LPP ne fuqi [...]

Neni 2 i LPP, referojmë[...]

Neni 20 "Mosdiskriminimi", i LPP [...]

Gjithashtu, vendimi i AK eshte marre ne kundershtrim me: Neni 53 referojmë [...], neni 55 pika 1[...]

Neni 55 pika 2[...]

Neni 55 pika 3[...]

Neni 55 pika 5[...]

Perfundimisht e kundërshtojmë këtë kualifikim të OE EURO INFORM shpk, si të paligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat sipërcituar dhe në gjithë arsyetimin ligjor të trajtuar në ankesën për OE ZEQIRI shpk.

Për këtë pikë, kërkojmë nga AK, si më poshtë:

1. Rivendosjen e ligjshmerisë në këtë procedurë prokurimi, faza e vlerësimit të ofertave,
2. Rivlerësimin dhe skualifikimin e ofertës së OE "EURO INFORM" sh.p.k, pasi ky operator ekonomik nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST dhe përgjigjen për sqarim.

Ankesa 3

Në lidhje me kualifikimin e OE "FASTECH" shpk, bëjmë me dije se:

A. Në nën pikën 2.3.4, të pikës "2.3 Kapaciteti teknik", të kriterëve të vecanta, të Dokumenteve të Tenderit, kërkojmë:

2.3.4. Pjesë të katalogut teknik për pajisjet kompjuterike që prokurohen (të jenë të perkthyer në shqip dhe të noterizuara)

Si pajisje kompjuterike të kerkuara në tender, janë:

| <b>NR</b> | <b>Emertimi I Pajisjes</b>    | <b>Sasia/cope</b> |
|-----------|-------------------------------|-------------------|
| 1         | UPS 1000VA                    | 45                |
| 2         | UPS 2000VA                    | 1                 |
| 3         | Kompjuter Desktop 1           | 41                |
| 4         | Kompjuter Desktop 2           | 4                 |
| 5         | Monitor Led 21" Brand         | 5                 |
| 6         | Printer All in One B&Ë        | 27                |
| 7         | Printer Color                 | 1                 |
| 8         | Hard Drive HDD External Brand | 10                |
| 9         | Tastiera                      | 30                |
| 10        | Mouse                         | 50                |
| 11        | HDD internal 500Gb            | 4                 |
| 12        | SSD e jashme                  | 1                 |

|    |   |     |
|----|---|-----|
| 13 | <i>Blllok ushqimi 650Ë</i>                          | 2   |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                              | 3   |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                                   | 4   |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                                   | 4   |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>                          | 1   |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>                         | 1   |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i>             | 2   |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                                 | 2   |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>                   | 200 |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>                    | 150 |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                                | 1   |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                               | 1   |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>                 | 1   |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>                   | 1   |
| 27 | <i>Psjjsje Rregjistrimi LIVE</i>                    | 1   |
| 28 | <i>Sëitche</i>                                      | 11  |
| 29 | <i>Printer B&amp;Ë Advanced</i>                     | 4   |
| 30 | <i>Fotokopje Multifunx B&amp; Ë Basic</i>           | 1   |
| 31 | <i>Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine</i> | 1   |
| 32 | <i>Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced</i>       | 1   |

*Per kete, ju bejme me dije se OE "FASTECH" shpk nuk ka paragitur kataloge të noterizuar, të perkthyer, per zerat si me poshte:*

|   |                                      |
|---|--------------------------------------|
| 8 | <i>Hard Drive HDD External Brand</i> |
|---|--------------------------------------|

|    |   |
|----|---|
| 9  | <i>Tastiera</i>                         |
| 10 | <i>Mouse</i>                            |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>               |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                     |
| 13 | <i>Blllok ushqimi 650Ë</i>              |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                  |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                       |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                       |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>              |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>             |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i> |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                     |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>       |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>        |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                    |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                   |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>     |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>       |
| 27 | <i>Psjisje Rregjistrimi LIVE</i>        |

*Praktikisht,*

*OE "FASTECH" shpk, nuk ka paraqitur pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen, si: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse. HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Blllok ushqimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabuli Rijeti Cat 5e(1kuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rijeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE.*

OE "FASTECH" shpk, nuk ka paraqitur të perkthyer specifikimet teknike per: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 5000b, SSD e jashme, Bllok ushgimi 650Ë, Kabllo Tension, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabull Rijeti Cat 5e(1kuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rijeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjjsje Rregjistrimi LIVE.

OE "FASTECH" shpk, nuk ka paragitur të noterizuara specifikimet teknike per: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb. SSD e jashme, Bllok ushgimi 650Ë, Kabllo Tension, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabull Rijeti Cat 5e(1kuti 305m), Karte Rijeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Ri jeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjjsje Rregjistrimi LIVE.

B. OE FASTECH shpk, ka ofertuar pajisje të cilat kane mangesi dhe nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike të kerkuara nga AK.

Praktikisht:

1. Kompiuter Desktop 1 (zeri 3 ):

Eshte kerkuar: DVD-RË

Produkti i ofertuar n

ga FASTECH, ka DVD-ROM

Eshte kerkuar: minimumi 3 PCI/PCI-E

Produkti i ofertuar nga FASTECH, ka 2 PCI-E

Eshte kerkuar: 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port

Produkti i ofertuar nga FASTECH, nuk e ka kete porte.

2.Pajisje Rregjistrimi Live (zeri 27):

Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK to krahasoje specifikirnet teknike to kerkuara me specifikimet e produktit to ofertuar, qe to plotesoje specifikimet:

Ekрани

Regjistrimi

Integrated/Integruar 17" / 43 cm 1920 x 1200 LED-backlit LCD

-20 hours at 1080i using 1 TB built-in hard drive set të record at 100 Mbps AVI MJPEG

CPU

RAM

Memoria

Karta Grafike

Six-Core processor 3.4 GHz

12 MB L3 cache, 130 Ë 16 GB

4 total DDR3 1600 MHz RAM (non-ECC)

(4 GB x 4 DIMM triple-channel configuration

1 TB, 7200 RPM SATA 2.5" internal hard drive

*CUDA Cores: 48, Graphics Clock (MHz): 810 MHz, Processor Clock (MHz): 1620, Memory Clock (MHz): 900 (DDR3), Standard Memory Config: 1GB (DDR3), Memory Interface Eëidth: 64-bit, Memory Bandëidth (GB/sec): 14.4, Standard Display Connectors: Dual Link DVI-I, HDMI, VGA*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

### *3.Karte Grafike (zeri 23)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikirnet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Minimurni Pass Mark Points: 5500 pike*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

### *4.Testues Rrieti (zeri 24)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK to krahasoje specifikimet teknike to kerkuara me specifikimet e produktit to ofertuar, qe to plotesoje specifikimet:*

*Testues Rrjeti RJ45,10Base2/BNC,RJI 1,USB and Fire ëare Cable*

*Modeli I Cabllit Per Kabull CATS Cat 6 dhe lidhjet ISDN*

*Te testoje gjatesi kabili Deri ne 180m (600ft)*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

### *5.Fotokopie Multifunksionale Color MPF Advanced (zeri 32)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK to krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Formati Maksimal i Letres "Media A3*

*Memorja "Memory": > 2 GB*

*"Hard Disk": > 250 GB*

*Shpejtesia e Skanimit "Scan Speed": > 45 ppm*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

### *6.Fotokopie Multifunksionale High Volume Copy Machine (zeri 31)*

*Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK to krahasoje specifikirnet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:*

*Formati i Leti es "Media Sizes": A3/A4*

*Memorja "Memory": > 2 GB*

*"Hard Disk": > 250 GB*

*Shpejtesia e Skanimit "Scan Speed": > 55 ppm*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.*

### *7. Printer B&Ë Advanced (zeri 29)*

*Ky OE nuk ka paragitur katalog qe AK to krahasoje specifikimet teknike to kerkuara me specifikimet e produktit to ofertuar, qe to plotesoje specifikimet:*

*Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality": 1200x1200 dpi*

*Kapaciteti ne Hyrje "Input Capacity"500 Flete*

-----

Memorja "Memory": 256 MB

Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.

#### 8. B11ok Ushqimi 650Ë (zeri 13)

Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:

Poëer Supply 650ë

Daljet 4 dalje sata ,2 dalje

Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.

#### 9. MONITOR 21"LED BRAND (zeri 13)

Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:

Koha e Rifreskimit "Response Time": 5 ms

Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime.

C. Ne pergjigjen e kerkeses per sqarim, të kesaj procedure prokurimi, nga AK kerkohet:

Per zerin 27 "Pajisje Rregjistrimi Live", nga OE kerkohet të dihet nese AK kerkon vetem dorezimin e saj apo kerkohet edhe instalimi-konfigurimi e integrimi?

AK ju ben me dije se: "Per kete pajisje kerkohet të jete i perfshire instalimi dhe konfigurimi i pajisjes me pajisje të tjera si mikrofoni, kompjuter dhe aparat fotografik" dhe keto konfigurime sikurse e shprehni edhe ju kerkojne nje specialist të kualifikuar e të certifikuar.

Sa me siper ju bejme me dije se OE "FASTECH" shpk nuk ka marre persiper instalimin dhe konfigurimin e pajisjes se rregjistrimit Live. KY OE as nuk ka specialiste per të tilla instalime. Ne pergjigjen ndaj kerkeses per sqarim, AK percakton:

Per keto pajisje duke gene se Jane pajisje specifrike dhe te brandeve të papercaktuar AK kerkon instalimin /konfigurimin e pajisjeve si dhe support të vazhdueshem per periudhen e mbulimit të garancise AK shprehet se per pajisjet e mesiperme montimi dhe konfigurimi do to realizohet nga nje specialist i certifikuar (nga brand-i perkates) per pajisjen konkrete (psh fotokopje). Ky specialist do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues ne momentin e levrimit të mallit të kerkuar apo venien ne funksionim të tij. Sa me siper, OE "FASTECH" shpk nuk ka stafin e kerkuar dhe nuk ploteson kapacitetin teknik e profesional.

I kujtojme AK, se ne Dokumentet e Tenderit, konkretisht ne piken 2.14 dhe 2.14.1, të Seksionit 2 "Objekti i kontrates", të Njoftimit të Kontrates, eshte percaktuar se nga AK nuk do të pranohen variantet dhe nuk do të pranohet nenkontraktimi.

Kjo do to thote se ofertuesi duhet ti realizoje instalimet e konfigurimet e kerkuara, me kapacitetet e veta. Kapacitete të tilla të cilat ky operator nuk i ka. Ose ne të kundert AK do të lejoje nenkontraktimin, qe ne kete rast eshte i ndaluar, ne kundershtrim me percaktimet e rregullave të konkurimit ne DT, e per rrjedhoje i paligjshem.

*Nje kualifikim i ketij OE, ne keto kushte, me keto mangesi ne oferte dhe kapacitete teknike e profesionale, perben haptazi trajtim të pabarabarte të ofertuesve. AK ka nxjerre nje vendim, pas nje procesi shqyrtimi të ofertave, pa barazi ne trajtimin e kerkesave dhe të detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.*

*Kjo e ben kete vleresim të pavlefshem e të pa ligjshem, konkretisht ne kundërshtim me dispozitat ligjore si me poshte referojmë[...] neni 46[..], neni2 [...], neni 20[..], të LPP-së[...]*

*Gjithashtu vendimi i AK-së është marrë në kundërshtim me:*

*Neni 53 pika 3[...]*

*Neni 53 pika 5/c[...]*

*Neni 55 pika 1[...]*

*Neni 55 pika 2[...]*

*Neni 55 pika 3[...]*

*Neni 55 pika 5[...]*

*Perfundimisht e kundërshtojme kete kualifikim të OE FASTECH shpk, si të paligjshem dhe ne kundërshtim me dispozitat sipercituar dhe ne gjithe arsyetimin ligjor të trajtuar ne ankesen per OE ZEQIRI shpk.*

*Per kete pike, kerkojme nga AK, si me poshte:*

- 1. Rivendosjen e ligjshmerise ne kete procedure prokurimi, faza e vleresimit të ofertave,*
- 2. Rivleresimin dhe skualifikimin e ofertes se OE "FASTECH" sh.p.k, pasi ky operator ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta to kualifikimit dhe specifikimet të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST dhe pergjigjen per sqarim.*

*Sa me siper, Perfundimisht kerkojme:*

*A. Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e Ankeses,*

*B. Shqyrtimin e ankeses se OE "PC STORE" sh.p.k.,*

*C. Vendosjen e ligjshmerise ne kete procedure prokurimi,*

*D. Rivleresimin e ofertave dhe skualifikimin e ofertes se OE "ZEQIRI" shpk, OE "FASTECH" sh.p.k., dhe OE "Euro INFORM" shpk, të cilat jane kualifikuar ne kundërshtim me Nenin 1, nenin 2, nenin 20, nenin 46, nenin 53 dhe nenin 55 to LPP, si dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen E Konkurrences" të ndryshuar.*

**II.5.** *Me shkresën nr. 5414/4 prot., datë 26.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:*

*[...]Ne pergjigje të ankeses tuaj protokolluar prane Bashkise Fier me nr.5474 prot., dt.18.06.2019, per tenderin me objekt "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike", si dhe bazuar ne nenin 63 to ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ne V.K.M. nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave to prokurimit publik"e ndjyshuar, neni 78, pika 5, ne to cilin theksohet: Gjate procedures se prokurimit, ankesat kunder vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorezohen fillimisht prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga dita e neserme punes, nga data kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet to ishte vene ne dyeni per kete shkelje të ligjit. Kryetari i Autoritetit Kontraktor menjehere pasi u njoftua ne lidhje me ankesen tuaj nxori urdherin e pezullimit të vazhdimet*



të procedurës me nr. 5474/1 prot., dt 18.06.2019, si dhe në të njëjtën datë urdheroi Komisionin për Shqyrtimin e Ankesës, duke qenë se nuk ka marrë pjesë në vendimmarrjen për të cilën është paraqitur ankesa, të njihet me ankesën e paraqitur në Bashkinë Fier nga Operatori Juaj Ekonomik dhe të dale me një vendim për të.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës pasi shqyrtoi të gjithë dokumentat e vena në dispozicion nga Njësia e Prokurimit si: dokumentat e hedhura në sistem prej justë, DST për këtë procedurë e cdo dokument tjetër të nevojshëm, i ka komunikuar Kryetarit vendimin si më poshtë:

Te mos pranojë ankesën Tuaj për arsyet si më poshtë:

Pas shqyrtimit të saj u konstatua se shoqëria "PC Store" sh.p.k. ka ankimuar kualifikimin e OE "Zeqiri" sh.p.k., "Euro Inform" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k., dhe konkretisht:

1. Vlerëson të padrejhtë kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. për arsyen se: nuk ka paraqitur në tender kataloge të noterizuar, të perkthyer për zërat e kërkuar në DST si:

UPS 1000 VA, Kompiuter Desktop 1, Kompjuter desktop 2 Monitor Led 21 etj .

Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit "Zeqiri" sh.p.k. të dorëzuara për këtë procedurë rezultoi se nga ky subjekt janë paraqitur kataloge të noterizuar për produktet e tenderuara në procedurën "Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike".

Për sa më sipër, pretendimi i shoqërisë "PC Store" sh.p.k. për këtë pikë nuk qëndron.

2. Vlerëson të padrejhtë kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. për arsyen se: Ky subjekt nuk ka paraqitur të perkthyerat specifike teknike për: UPS 1000 VA. UPS 200 Va Kompiuter Desktop 1, Kompjuter desktop 2, Monitor Led 21 etj Printer All in One B&Ë etj.

Komisioni i KSHA konstaton se në DST në Shtojcën nr.9 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" paragrafi 1, citohet shprehimisht

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

..... ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

Në asnjë paragraf, shtojcë tjetër apo kriter të DST nuk kërkohet paraqitja e specifikimeve teknike për cdo produkt të prokuruar në këtë procedurë, të perkthyerat dhe të noterizuara.

Shtojca Nr.6 e deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, rezultoi të jetë paraqitur nga OE "Zeqiri" sh.p.k. në sistem.

Për sa më sipër, pretendimi i shoqërisë "PC Store" sh.p.k. për këtë pikë nuk qëndron.

3. Vlerëson të padrejhtë kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. për arsyen se: Nuk ka paraqitur të noterizuara specifike teknike për UPS 1000 VA. UPS 200 Va, Kompiuter Desktop 1, Kompjuter desktop 2, Monitor Led 21 etj Printer All in One B&Ë etj

Komisioni i KSHA konstaton se në DST në Shtojcën nr.9 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" paragrafi 1, citohet shprehimisht

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

Në asnjë paragraf, shtojcë tjetër apo kriter të DST nuk kërkohet paraqitja e specifikimeve teknike për cdo produkt të prokuruar në këtë procedurë, të perkthyerat dhe të noterizuara.

Shtojca Nr.6 e deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike rezultoi të jetë paraqitur nga OE "Zeqiri" sh.p.k. në sistem.

*Per sa me siper, pretendimi i shoqerise "PC Store" sh.p.k. per kete pike nuk qendron.*

*4. Vlereson to padrejte kualifikimin e subjelctit "Zeqiri" sh.p.k. per arsyen se: Nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme me natyren dhe zerat e objektit të prokurimit.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankeses verifikoi dokumentacionin e paraqitur per permbushjen e kriterit të kontratave të ngjashme paraqitur nga ky operator dhe rezulton se nga ky subjekt jane paraqitur kontratat:*

*a- "Blelje televizore, Led 28 INCH per nevoja të SHPMPB Durres per vitin 2016" me nr.218 prot date.07.11.2016 me vlere pa TVSh 1,294,800 leke.*

*b- "Blerje materiale zyre dhe të pergjithshme" per Bashkine Cerrik me nr.1248/1 Prot date. 16.04.2018 me vlere pa TVSH 3,086,000 leke.*

*KSHA llogariti vleren qe i takonte per produktet e ngjashme ne kete procedure (kompjuterat dhe pajisjet kompjuterike) e cila i korrespondon ne vleren 565,800 leke pa TVSH.*

*c- "Blelje pajisje elektronike" per Bashkine Cerrik me nr.1240 prot date.16.04.2018 me vlere pa TVSh 1,480,000 leke.*

*Per sa me siper, pretendimi i shoqerise "PC Store " sh.p.k. per kete pike nuk qendron.*

*5. Vlereson të padrejte kualifikimin e subjelctit "Zeqiri" sh.p.k. per arsyen se: Nuk ka paraqitur certifikaten ISO 9001-2015 per objektin e prokurimit dhe nuk eshte e noterizuar.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankeses verifikoi certifikaten ISO 9001-2015 dhe rezulton se eshte paraqitur nga ky subjekt dhe eshte certifikuar nga RIGCERT me nje afat deri ne dt.04.04.2022. Fusha e certifikimit per të cilen eshte certifikuar shoqeria Zeqiri citon "Tregtimi, furnizimi dhe shperndarja e automjeteve, makinerive, pjeseve të kembimit dhe veglat e punes. Tregtimi, furnizimi dhe shperndarja e materialeve hidraulike, mekanike, elektrike dhe elektronike , IT,*

*Hekurudhore etj etj»*

*Per sa me siper, pretendimi i shoqerise "PC Store " sh.p.k. per kete pike nuk qendron.*

*6. Vlereson të padrejte kualifikimin e subjelctit "Zeqiri" sh.p.k. per arsyen se: Pajisjet e ofruara nga OE "Zeqiri" sh.p.k. per kete procedure nuk plotesojne kerkesat teknike të kerkuara.*

*KSHA nga gjithë verifikimi i dokumentacionit të OE "Zeqiri" sh.p.k., nuk konstaton se ky operator nuk mund të mos plotesoje kerkesat teknike apo mos to realizoje me sukses kontraten, pasi ai ka plotesuar të gjitha kriteret e pergjithshme dhe të vetcanta të kualifikimit per kete procedure të vendoura nga AK-ja. Gjithashtu OE "Zeqiri" sh.p.k. ka treguar se ka kapacitete teknike dhe ekonomike per realizimin e kontrates sipas standarteve dhe specifikimeve të vendosura ne DST nga AK Bashkia Fier. Nisur sa me siper pretendimet e shoqerise "PC Store " sh.p.k. ne lidhje me kualifikim të padrejte të subjektit "Zeqiri" sh.p.k. nuk qendrojne.*

*KSHA gjykon se, per sa kohe qe pretendimet e mesiperme të operatorit ekonomik ankimues per skualifikimin e operatorit ekonomik "Zeqiri" sh.p.k. nuk qendrojne, pasi ky i fundit permbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KSHA-se do to mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit ne lidhje me kualifikimin e operatoreve ekonomike "Euro Inform" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k., nuk kane ndikim mbi fatin e ceshtjes, pasi bazuar ne legjislacionin ne fuqi per prokurimin publik, interesi i ligjshem i drejtperdrejte i ankimuesit, nuk ka sesi të demtohet nga sukcesi apo deshtimi i operatoreve të tjere ne kete procedure prokurimi, pasi edhe ne hipotezen qe keto*

*pretendime do të pranoheshin, ai serish nuk do to mund të shpallej fitues i kontrates objekt prokurimi, duke qene se ne renditjen perfundirntare, para tij qendron nje tjeter operator ekonomik i kualifikuar. Nisur keto kushte, K.SH.A gjykon qe pretendimi i ankimuesit nuk do tëmerret ne shqyrtim. Nisur nga sa me siper pretendimet e operatorit ekonomik "PC Store " sh.p.k. per kete procedure nuk qendrojne dhe vleresimi i bere nga KVO eshte i drejte dhe ne perputhje me kerkesat e Ligjit 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr.914 dt.29.12.2014 "Per Miratimin e rregullave to prokurimit publik" i ndryshuar.*

II.6. Në datën 02.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Zeqiri” sh.p.k., “Euro Inform” sh.p.k. dhe “Fastech” sh.p.k.. Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

*[...]1. (Fakte mbi proceduren)*

*Me daten 10 Qershor 2019, OE "PC STORE" sh.p.k, ka marre pjese ne proceduren e prokurimit me mjete elektronike të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor- Bashkia Fier, me objekt "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike", me Nr. REF-22199-05-15-2019, me fond limit 8 302 109*

*Ieke pa TVSH. Me date 13 Qershor 2019, ne llogarine tone të mesazheve ne SPE, nga AK ka ardhe njoftimi elektronik me subjekt: Vleresimet per tenderin "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike" (Faza e vleresimit të tenderit), ku njoftohemi se ofertajone eshte kualifikuar e suksesshme. Njekohesisht me kete njoftim verejme kualifikimin të suksesshem edhe të tre operatoreve të tjere pjesemarres, konkretisht OE "ZEQIRI" shpk, "EURO INFORM" shpk dhe "FASTECH" shpk, të cilet jane kualifikuar ne kundershkrim me ligjin. Kete vleresim të AK Bashkia Fier, e kemi kundershmtuar me ane të Formularit të Ankeses (bashkelidhur), të derguar prane AK nepermjet postes shqiptare, me sherbim rekomande me gjurmim ne kohe reale, brenda afateve ligjore të ankimimit (konkretisht derguar me date 17.06.2019). Ne ankese kerni paraqitur të argumentuar cenimin e pozites tone tregetare dhe interesit tone të ligjshem per t qene fitues ne kete procedure. Kemi paraqitur pretendimet tona, të argumentuara, mbi shkeljet ligjore të AK ne procesin e shqyrtirnit të ofertave. Si dhe mangesite e ofertave të paraqitura nga ofertuesit e tjere pjesemarres, të ciletjane kualifikuar padrejtesisht si të vlefshem. Per kete ankese, Ju bejme me dije se, sipas sistemit elektronik të pontes shqiptare per gjurmimin e shkreses/ankeses se derguar, rezulton qe ajo eshte dorezuar prane AK Bashkia Fier me date 18.06.2019. (per kete gjeni bashkelidhur deftesen postare per postimin e ankeses dhe nje kopje të puintuar të permbledhjes se sistemit elektronik postar mbi gjurmimin e ankeses, ku vertetohet dorezirni ne AK me date 18.06.2019). Gjithashtu bejme me dije se, pergjigja (jo vendimi), nga AK Bashkia Fier, eshte derguar prane OE PC STORE me date 01 Korrik 2019 (14 dite pas dates se mbritjes se ankeses tone prane AK, dhe ne shkelje të pikes 5 te nenit 63 to LPP).*

*Pergjigja ka ardhe me shkresen Nr. 5474/4Prot., date 26.06.2019, ku nga data qe kjo shkrese mban, vrejme se pergjigja/vendimi i AK nuk eshte marre brenda 7 diteve pas marrjes se ankeses, sic e kerkon pika 5 e nenit 63 to LPP. Me gjithate, pavaresisht faktit të mos respektimit të afateve ligjore nga AK, bejme me dije se pergjigja me shkrese Nr. 5474/4Prot., date 26.06.2019 nga AK Bashkia Fier eshte nje*

pergjigje refuzuese. Dhe me qellim mbrojtjen e interesit tone të ligjshem, jemi të detyruar të trajtojmë ate. Nepermjet pikës II dhe III të trajtuar më poshtë, ju paraqesim argumentet e ankesës tone, për kundërshtimin e vleresimit të ofertave.

II. (Argumentet e ankesës së OE "PC STORE" shpk, të paraqitur pranë AK për kundërshtimin e pranimit / kualifikimit të ofertave të OE "ZEQIRI" shpk, OE "EURO INFORM" shpk dhe OE "FASTECH" shpk.) Lutemi referojuni Formularit të Ankesës drejtuar AK-së, që gjendet bashkelidhur kësaj ankesë.

III. (Pergjigja/Vendimi i AK, për shqyrtimin e ankesës dhe kundërshtimet e OE "PC STORE" sh.p.k,) AK ka përcjelle shkresën Nr. 5474/4Prot., datë 26.06.2019, lenda: Kthim pergjigje në lidhje me ankesën për tenderin me objekt "Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike", të ankesës së OE "PC STORE" sh.p.k. Në vendim, në teresi vërejmë një qëndrim teresisht arbitrar e të njëanshm, vërehet se AK i referon pergjigjet e veta bazuar në keq interpretim të disa paragrafeve të marra nga ankesa jone. AK nuk tregon trajtim në teresi të ankesës madje injoron ceshtjet thelbesore të trajtuara nga PC Store, a thua se ato nuk janë shkruar fare në ankesë.

AK/ KSHA, në trajtimin e ankesës nuk ka bërë një trajtim të të gjithë dokumenteve të kësaj procedure. Vërehet se Ankesa jone nuk është lexuar dhe trajtuar nepermjet një procesi të rregullt, serjooz dhe të paanshem. Gjithashtu, vërejmë një nxitim të AK për të mospranuar ankesën. Ndryshe nga përcaktimet ligjore, AK nuk është shprehur me vendim të arsyetuar ndaj ankesës tone (për çdo pikë ankesë të paraqitur nga ana jone), por thjesht është shprehur shkurt se ankesa nuk qëndron. AK është shprehur vetëm për njërin nga pikat e ankesës tone. Vërehet gjithashtu se AK është kontradiktor në pergjigjet e veta, pasi i nxjerr ato në kontradikte me njëra tjetren.

Me poshtë do të gjeni pergjigjen e AK, përcjelle me shkresë Nr. 5474/4Prot., datë 26.06.2019, pranë OE PC STORE, citoj:

(për secilën pergjigje të AK do të gjeni nderhyrjen e OE PC STORE me sqarimet perkatëse)

1. Për Ankesën 1, të paraqitur në Formularin e Ankesës nga OE PC STORE, AK shprehet: Të mos pranojë ankesën tuaj për arsytet si më poshtë:

Pas shqyrtimit të saj u konstatua se shoqëria "PC Store" sh.p.k. ka ankimuar kualifikimin e OE "Zeqiri" sh.p.k., "Euro Inform" sh.p.k. dhe "Fastech" sh.p.k., dhe konkretisht: 1. Vlereson të padrejtte kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. për arsyen se: nuk ka paraqitur në

tender kataloge të noterizuar, të perkthyer për zërat e kerkuar në DST si: UPS1000VA, Kompjuter Desktop 1, Kompjuter desktop 2, Monitor Led 21 etj etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit "Zeqiri" sh.p.k. të dorëzuara për këtë procedure rezulton se nga ky subjekt janë paraqitur kataloget e noterizuar për produktet e tenderuara në procedurën "Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike".

Për sa më sipër, pretendimi i shoqërisë "PC Store" sh.p.k. për këtë pikë nuk qëndron.

1.1 Nga ana jone, Ne PC STORE, kundërshtojmë këtë pergjigje të AK pasi edhe njëherë theksojmë se AK nuk i është prgjigjur kerkesave tona.

KSHA i shmanget qëllimisht konstatimeve mbi paligjshmerinë e ofertës së OE Zeqiri, dhe me vetedije zgjedh të vleresojë vetëm dokumentacionin që ajo deshiron, duke heq lexuar kështu ankesën e bërë nga ana jone.

Sic verehet me siper, AK per kete pike, ne pergjigje shprehet se: Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit "Zeqiri" sh.p.k. të dorezuara per kete procedure rezulton se nga ky subjekt kane paraqitur kataloget e noterizuar per produktet e tenderuara ne proceduren "Blerje kompiutera dhe pajisje elektronike"..

Pra, lehtesisht verehet se AK pergjigjet vetem per faktin nese jane të noterizuara, por nuk shprehet nese jane të perkthyer ne shqip. E ka anashkaluar kete kusht kualifikues të kerkuar ne DST ne nen piken 2.3.4, të pikes "2.3 Kapaciteti teknik", të kriterëve të vecanta, ku kerkohet: 2.3.4. Pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara)

Madje sa i takon noterizimit të katalogeve, shprehet se, janë paraqitur kataloget e noterizuar per produktet e tenderuara ne proceduren "Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike ", qe do to thote se OE Zeqiri i ka paraqitur kataloget e noterizuar per të gjithë produktet, pa perjashtuar asnje prej tyre. AK ne kete pike ka mashtruar me pergjigjen e dhene, duke treguar njeanshmeri dhe mos transparence, pasi ky OE per të cilin kerkojme skualifikimin e tij, jo vetem qe nuk i ka paraqitur per të gjithë zerat kataloget e noterizuar, por as per ato qe perfshin perkufizimi pajisje kompjuterike. Gjithashtu ky OE ofertues nuk ka paraqitur kataloge apo pjese katalogu të perkthyer ne shqip.

2.Ne piken 2 dhe 3 të pergjigjes AK shprehet:

2.Vlereson të padrejte kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. per arsyen se: Ky subjekt nuk ka paraqitur të perkthyer specifikimet teknike per: UPS 1000 VA. UPS 200 Va, Kompjuter Desktop 1, Kompjuter desktop

2. Monitor Led 21 eti eti Printer All in One B&Ëeti eti.

3.Vlereson të padrejte kualifikimin e subjektit "Zeqiri" sh.p.k. per arsyen se: Nuk ka paraqitur të noterizuara specifikimet teknike per UPS 1000 VA. UPS 200 Va, Kompiuter Desktop 1. Kompiuter desktop 2, Monitor Led 21 eti eti Printer All in One B&Ë etj etj. Komisioni i KSHA konstaton se ne DST ne Shtojcen nr.9 "Kriteret e vecanta të kualifikirnit" paragrafi 1, citohet shprehimisht Kandidati/Ofertuesi duhet të dorezoje:

.....g.Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojces 6;

Ne asnje paragraf. shtojce tjeter apo kriter të DST nuk kerkohet paraqitja e specifikimeve teknike per cdo produkt të prokuruar ne kete procedure të perkthyer dhe të noterizuara. Shtojca Nr.6 e deklarates rmbi permbushjen e specifikimeve teknike, rezulton të jete paraqitur nga OE "Zeqiri " sh.p.k. ne sistem. Per sa me siper, pretendimi i shoqerise "PC Store" sh.p.k. per kete pike nuk qendron.

2.1 Nga ana jone, Ne PC STORE, kundershtojrne kete pergjigje të AK pasi edhe njehere theksojme se AK nuk i eshte prgjigjur kerkesave tona.

Sic verehet me siper, AK per kete pike, ne pergjigje shprehet se: Ne asnje paragraf, shtojce tjeter apo kriter të DST nuk kerkohet paraqitja e specifikimeve teknike per cdo produkt të prokuruar ne kete procedure, tëperkthyer dhe të noterizuara. Shprehet keshtu duke u perpjekur të justifikojte dhe të shkarkojte ofertuesin nga detyrimi per paraqitjen e specifikimeve teknike të perkthyer e të noterizuara (harron qe specifikimet gjenden të kataloget e kerkuar).

AK harron qe ne piken 1 eshte shprehur se Jane paraqitur- kataloget e noterizuar per produktet e tenderuara ne proceduren ' Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike ".(pa perjashtuar asnje

produkt) Keto kontradikta të AK theksojnë dhe një here një vleresim arbitrar e të paligjshëm. AK harron që në DST në nenin 2.3.4, të pikës "2.3 Kapaciteti teknik", të kriterëve të vecanta, kërkohej: 2.3.4. Pjesë të katalogut teknik për pajisjet kompjuterike që prokurohen (të jenë të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) AK harron që në pikën 4.6 të "Seksioni 4 Procedura", të "I NJOFTIMI I KONTRATES" të DST është percaktuar se: Gjuha (-et) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Pra, është kërkuar që gjuha e ofertave është gjuha shqipe.

AK harron që në pikën 1.1, të "Seksioni 1. Hartimi i ofertes", të "II. UDHEZIME PËR OPERATORET EKONOMIKE", të DST, ofertuesve u është bërë e ditur dhe është percaktuar se: Operatoret Ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e percaktuara në keto DT Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me keto DT do të refuzohen si të papranueshme. AK, ka dhënë një përgjigje të përgjithshme dhe nuk është shprehur të paktën për pajisjet kompjuterike, nëse ofertuesi ka paraqitur pjesë katalogu të perkthyer në shqip për të. AK harron që në pikën 2 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", të Shtojcës 9 të DST, ofertuesve u është bërë e ditur dhe është percaktuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, use të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. AK ka vlerësuar në kundërshtim me nenin 53 të LPP, ku percaktohet citoj: Neni 53, pika 3.

Autoriteti kontraktor. në zbatim të pikës 4 të këtij Neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontrates dhe në dokumentet e tenderit, pa qenë ndesh me percaktimet e Nenit 54 të këtij ligji.],

AK konsideron paraqitjen e Shtojcës Nr.6 deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si përmbushje të kërkesave që lidhen edhe me paraqitjen e katalogeve të perkthyer dhe të noterizuara. Në këtë mënyrë, haptazi AK tregon cilesinë e shqyrtimit të ofertave, ku AK nuk i merr në konsideratë specifikimet e paraqitura nëpërmjet katalogeve pasi mjaftohet vetëm me paraqitjen e deklaratës së plotësuar sipas shtojcës 6 të dst. Pra në standardet e vlerësimit të AK Bashkia Fier, një ofertë me mangësi si ajo e OE Zeqiri shpk, kualifikohet si e vlefshme edhe nëse ajo nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontrates dhe në dokumentet e tenderit, sic është kërkesa për katalogun në gjuhën shqipe. Sa me sipër, jemi të bindur që AK Bashkia Fier, ka përdorur të njëjtin standard vlerësimi dhe shqyrtimi, me të njëjtat shkelje ligjore, edhe për ofertat e operatoreve të tjere. Një vlerësim i tillë është i pa ligjshëm. Është i pa pranueshëm nga ana jone pasi, në si OE ofertues, për këtë procedurë prokurimi, jemi angazhuar me kosto financiare dhe burime njerëzore, dhe kemi hartuar një ofertë të suksesshme, në përgjigje të plotë të kushteve të gares, për të fituar kontratën. Ndersa, sic shihet, AK nuk i respekton kushtet që vete ka vendosur dhe kualifikon të gjithë ofertuesit pjesëmarrës edhe pse ata nuk kanë hartuar oferta të suksesshme.

Një kualifikim i këtij OE dhe OE-ve të tjere, në keto kushte, me mangësi në oferta sipas atyre që kemi paraqitur në formularin e ankesës pranë AK, përben haptazi trajtim të pabarabartë të ofertuesve. AK ka nxjerrë një vendim, pas një procesi shqyrtimi të ofertave, pa barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Pra, praktikisht, AK pasi ka caktuar në DT kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë operatoret ofertues për të qenë të suksesshëm, me pas i ka shkelur vete ato në fazën e vlerësimit të ofertave, duke mos i marrë në konsideratë ato, e duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 53 të LPP. Kjo e ben këtë vlerësim të pavlefshëm e të pa ligjshëm, konkretisht në kundërshtim me dispozitat ligjore si me poshtë referojmë: Neni 46, neni 2, neni 20 neni

53 pika 3 dhe pika 5 c si dhe neni 55 pika1; pika2; pika 3; pika 5 i LPP-së[...] Sa me siper, AK ka kualifikuar të vlevshme oferten e OE Zeqiri shpk dhe OE-ve të tjere, ne kundershjim me nenin 46 to LPP, pasi pasi ky OE dhe të tjeret nuk kane permbushur të gjitha kriteret e kualifikimit, qe autoriteti kontraktor i ka vleresuar të nevojshme.

AK ka kualifikuar të vlevshme oferten e OE Zeqiri shpk dhe OE-ve to tjere, ne kundershjim me nenin 2 të LPP, pasi AK nuk ka trajtuar me barazi dhe paanshmeri operatoret ekonomik pjesemarres, ne procesin e vleresimit të ofertave.

AK, ka kerkuar ne DT, qe OE-te per të kualifikuar duhet të paraqesin pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara), pas kesaj, ne procesin e shqyrtimit të ofertave AK nuk e ka marre ne konsiderate kete kusht dhe i ka kualifikuar si të suksesshem të gjithë operatoret ekonomik edhe pse jo kushtet e AK i ploteson vetem Oferta e OE PC STORE. Me kete proces të pa rregullt të shqyrtimit të ofertave, AK ka nxitur konkurrencen e pandershme, ku nje OE duhet të plotesoje kushtet e kualifikimit qe të shpallet i suksesshem, e nje OE tjeter shpallet i suksesshem edhe pse nuk i ploteson ato. Ky eshte haptazi nje diskriminim ne procedure. Eshte nje trajtirn diskriminues midis OE-ve, i ndaluar me nenin 20 të LPP. Vleresimi i AK eshte absurd pasi e bazon garen vetem ne cmimin me të ulet, nderkohe qe LPP thot Neni 55, pika 1. Oferta fituese duhet të jete: a) oferta qe ne baze të kerkesave dhe kriterëve të percaktuara ne dokumentet e tenderit. ploteson kerkesat e objektit të prokurimit me cmimin me të ulet.

Pra me pare OE-te duhet të plotesoje kushtet e kualifikimit, e me pas midis OE-ve qe i plotesoje, do to shpallet fitues ajo qe ka cmimin me të ulet. Dhe ne keto kushte, OE Zeqiri dhe të tjeret nuk i plotesoje kriteret e kualifikimit të DT, e per rjedhoje oferta financiare e tyre nuk duhet dhe nuk mund to krahasohet me ato to ofertuesit PC STORE, si dhe nuk mund të jene fitues ne kete procedure prokurimi pervec OE PC STORE shpk. Sipas nenit 53 pika 3, të LPP, AK e vlereson nje oferte të vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me të gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Ne rastin konkret oferta e OE Zeqiri dhe e të tjerëve, eshte vleresuar e vlefshme ne kundershjim me nenin 53 të LPP. AK e ka vleresuar të vlefshem oferten e OE ZEQRIRI edhe pse ajo nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DST dhe shkreses per sqarim. Ky eshte nje kualifikim i pa ligjshem.

Sipas nenit 55 pika 2, të LPP, AK e vlereson nje oferte të vlefshme, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit, dhe nuk duhet të perdoret asnje kriter qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit.

AK nuk ka respektuar kete dispozite, gjithashtu AK ka perdorur kriteret të tjera qe nuk jane të parashikuara ne DT por qe jane lejuese per oferten e OE ZEQRIRI shpk dhe të tjerëve. Ne si OE duhet të ishim njohur me pare me keto kriteret lejuese, qe lejojne ofertuesit qe nuk permbushin kriteret e kualifikimit, të konsiderohen të suksesshem. Kjo ka sjelle nje vendim të pa ligjshem të AK, nje akt administrativ të pa ligjshem.

AK, eshte gjithashtu haprazi prornovuese dhe nxitese e kufizimit të konkurrences dhe shkeljes se ligjit per mbrojtjen e konkurrences. Ne Nenin 4 "Marreveshjet e ndaluara" të Ligji Nr. 9121, date 28.7.2003 "PER MBROJTJEN E KONKURRENCES" të ndryshuar, gjejme se citojmë:

[1. Ndalohen të gjitha marreveshjet të cilat kane si objekt ose si pasoje pengimin kufizimin ose shtremberimin e konkurrencës në treg, vecanerisht marreveshjet që:

a) caktojnë në mënyrë të drejtperdrejte ose të terthorte, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;

b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

ç) në marrëdhëniet tregtare me palet e tjera zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta. duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrençe;

d) kushtezojnë lidhjen e kontratave një pranimin nga palet e tjera kontraktuese të detyrimeve shtese për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar nuk kanë lidhje me objektin e ketyre kontratave.

Pra, në kundërshtim me këto ligj, AK nxit dhe lejon pengimin, kufizimin ose shtremberimin e konkurrencës në treg. AK gjatë procesit të konkurimit, ndryshon dhe cakton kushte të tjera tregtimi. AK, zbaton kushte të ndryshme për rregulla të njëjta, duke i vendosur OE-te në gjendje të pafavorshme konkurrençe. Sa me sipër, i kërkojnë KPP-se të shqyrtoj në themel këte procedurë, duke vlerësuar ofertat e paraqitura dhe të vendosë ligjshmerinë në këte proces.

II.7. Në datën 11.07.2019, nëpërmjet shkresës me nr.6105/1 prot., datë 08.07.2019, me objekt: “Dërgim Informacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kompjuterash dhe pajisje elektronike””, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” sh.p.k.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” sh.p.k. për arsye se: “Ankesa1 [...] OE ZEQIRI shpk nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme me natyrën dhe zërat e objektit të prokurimit.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në këte rast vlera e kërkuar është jo më pak se 300 000 leke pa tvsh (vlerë e cila nuk është më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Per këte pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtem:



*Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*

ose

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*

III.1.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, për plotësimin e kërkesës së mësipërme është paraqitur dokumentacioni:

- 1. Kontratën nr. 1248/1 prot., datë 16.04.2018 të lidhur me Bashkinë Cërrik me objekt: “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, me vlerë pa TVSH 471.500 lekë, shoqëruar faturë tatimore, me vërtetimin e realizimit të kësaj kontrate me nr. 2852 prot., datë 27.08.2018.*
- 2. Kontratën nr. 1249 prot., datë 16.04.2018 të lidhur me Bashkinë Cërrik me objekt: “Blerje pajisje elektronike”, me vlerë pa TVSH 148.000 lekë, shoqëruar faturë tatimore, e me vërtetimin e realizimit të kësaj kontrate me nr. 2852/1 prot., datë 27.08.2018.*
- 3. Kontratën me nr. nr.218 prot date.07.11.2016, të lidhur me Shtëpia e Pushimit Durrës, me objekt: “Blerje televizorë, Led 28 INCH për nevoja të SHPMPB Durrës për vitin 2016””, me vlerë 1.294.800 lekë pa TVSH, shoqëruar me vërtetimin e realizimit të kësaj kontrate nr. 7prot,...*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*

III.1.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet:

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara*

III.1.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në plotësim të dëshmimeve të eksperiencave të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, objekt ankimi, operatori ekonomik ankimues "Zeqiri" sh.p.k. ka dorëzuar në SPE, kontratat e sipërcituara. Nga verifikimi i kryer, KPP konstaton se me anë të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik "Zeqiri" sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike si më sipër cituar, ky i fundit nuk dëshmon se ka kryer furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Rrjedhimisht dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizime të ngjashme pasi shumat e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është në një vlerë më të vogël se 40 % e vlerës totale të fondit limit të parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues "PC Store" sh.p.k. mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik "Zeqiri" sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Zeqiri" sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorëve ekonomikë "Zeqiri" sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik "Euro Inform" sh.p.k. për arsye se: *"Ne lidhje me kualifikimin e OE "EURO INFORM" shpk, bejme me dije se: A. Ne nen piken 2.3.4, të pikes "2.3 Kapaciteti teknik", të kriterëve të vecanta, të Dokumentëve të Tenderit, kerkohet:*

*2.3.4. Pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene të perkthyer ne shqip dhe të noterizuara)*

*Si pajisje kompjuterike të kerkuara ne tender, jane:*

| <i>NR</i> | <i>Emertimi I Pajisjes</i>       | <i>Sasia/cope</i> |
|-----------|----------------------------------|-------------------|
| 1         | UPS 1000VA                       | 45                |
| 2         | UPS 2000VA                       | 1                 |
| 3         | Kompjuetr Desktop 1              | 41                |
| 4         | Kompjuter Desktop 2              | 4                 |
| 5         | Monitor Led 21" Brand            | 5                 |
| 6         | Printer All in One B&Ë           | 27                |
| 7         | Printer Color                    | 1                 |
| 8         | Hard Drive HDD External Brand    | 10                |
| 9         | Tastiera                         | 30                |
| 10        | Mouse                            | 50                |
| 11        | HDD internal 500Gb               | 4                 |
| 12        | SSD e jashme                     | 1                 |
| 13        | Blllok ushqimi 650Ë              | 2                 |
| 14        | Kabllo Tensioni                  | 3                 |
| 15        | Kabllo VGA                       | 4                 |
| 16        | Kabllo DVI                       | 4                 |
| 17        | Konvertues USB -DVI              | 1                 |
| 18        | Konvertues USB -HDMI             | 1                 |
| 19        | Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m) | 2                 |
| 20        | Karte Rrjeti                     | 2                 |
| 21        | Konektor Cat 5e (Koka LAN)       | 200               |
| 22        | Konektor Cat 6 (Koka LAN)        | 150               |
| 23        | Karte Grafike                    | 1                 |

|    |   |    |
|----|---|----|
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                               | 1  |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>                 | 1  |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>                   | 1  |
| 27 | <i>Psjise Rregjistrimi LIVE</i>                     | 1  |
| 28 | <i>Sëitche</i>                                      | 11 |
| 29 | <i>Printer B&amp;Ë Advanced</i>                     | 4  |
| 30 | <i>Fotokopje Multifunx B&amp; Ë Basic</i>           | 1  |
| 31 | <i>Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine</i> | 1  |
| 32 | <i>Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced</i>       | 1  |

*Për këtë ju bëjmë me dije se OE "EURO INFORM" shpk nuk ka paraqitur kataloge te noterizuar, te perkthyer, per zerat si me poshte:*

|    |   |
|----|---|
| 8  | <i>Hard Drive HDD External Brand</i>    |
| 9  | <i>Tastiera</i>                         |
| 10 | <i>Mouse</i>                            |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>               |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                     |
| 13 | <i>Blllok ushqimi 650Ë</i>              |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                  |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                       |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                       |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>              |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>             |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i> |

|    |                                     |
|----|-------------------------------------|
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                 |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>   |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>    |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>               |
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i> |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>   |
| 27 | <i>Psjisje Rregjistrimi LIVE</i>    |

*Praktikisht,*

*o OE "EURO INFORM" shpk, nuk ka paraqitur pjese të katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen, si: Hard Drive HDD External Brand, Tastiera, Mouse, HDD internal 500Gb, SSD e jashme, Bllok ushgimi 650Ë, Kabllo Tensioni, Kabllo VGA, Kabllo DVI, Konvertues USB -DVI, Konvertues USB -HDMI, Kabul] Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m), Karte Rrjeti, Konektor Cat 5e (Koka LAN), Konektor Cat 6 (Koka LAN), Karte Grafike, Testues Rrjeti, Set Kacavid-ash Profesionale, Pinca prerese Profesionale, Psjisje Rregjistrimi LIVE.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në pikën 1 të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “2.3.4 *Pjese te katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara).*”

III.3.2. Ndërsa në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi.

III.3.3. Në shtojcën 12, “Sasi dhe grafiku i lëvrimit”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

#### **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

| <i>NR</i> | <i>Emertimi I Pajisjes</i> | <i>Sasia/cope</i> |
|-----------|----------------------------|-------------------|
|-----------|----------------------------|-------------------|

|    |   |     |
|----|---|-----|
| 1  | <i>UPS 1000VA</i>                       | 45  |
| 2  | <i>UPS 2000VA</i>                       | 1   |
| 3  | <i>Kompjuetr Desktop 1</i>              | 41  |
| 4  | <i>Kompjuter Desktop 2</i>              | 4   |
| 5  | <i>Monitor Led 21" Brand</i>            | 5   |
| 6  | <i>Printer All in One B&amp;Ë</i>       | 27  |
| 7  | <i>Printer Color</i>                    | 1   |
| 8  | <i>Hard Drive HDD External Brand</i>    | 10  |
| 9  | <i>Tastiera</i>                         | 30  |
| 10 | <i>Mouse</i>                            | 50  |
| 11 | <i>HDD internal 500Gb</i>               | 4   |
| 12 | <i>SSD e jashme</i>                     | 1   |
| 13 | <i>Bllok ushqimi 650Ë</i>               | 2   |
| 14 | <i>Kabllo Tensioni</i>                  | 3   |
| 15 | <i>Kabllo VGA</i>                       | 4   |
| 16 | <i>Kabllo DVI</i>                       | 4   |
| 17 | <i>Konvertues USB -DVI</i>              | 1   |
| 18 | <i>Konvertues USB -HDMI</i>             | 1   |
| 19 | <i>Kabull Rrjeti Cat 5e(1kuti 305m)</i> | 2   |
| 20 | <i>Karte Rrjeti</i>                     | 2   |
| 21 | <i>Konektor Cat 5e (Koka LAN)</i>       | 200 |
| 22 | <i>Konektor Cat 6 (Koka LAN)</i>        | 150 |
| 23 | <i>Karte Grafike</i>                    | 1   |
| 24 | <i>Testues Rrjeti</i>                   | 1   |

|    |   |    |
|----|---|----|
| 25 | <i>Set Kacavid-ash Profesionale</i>                 | 1  |
| 26 | <i>Pinca prerese Profesionale</i>                   | 1  |
| 27 | <i>Psjjsje Rregjistrimi LIVE</i>                    | 1  |
| 28 | <i>Sëitche</i>                                      | 11 |
| 29 | <i>Printer B&amp;Ë Advanced</i>                     | 4  |
| 30 | <i>Fotokopje Multifunx B&amp; Ë Basic</i>           | 1  |
| 31 | <i>Fotokopje Multifunx High Volume Copy machine</i> | 1  |
| 32 | <i>Fotokopje Multifunx Color MFP Advanced</i>       | 1  |

*Afatet e lëvrimet: 20 dite nga nenshkrimi i kontrates .*

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- *Shtojcën 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”.*
- *Katalog për disa nga produktet e ofruara.*

III.3.5. Në nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”.*

III.3.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.7. Në nenin 27, “Kontratat e mallrave” pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

III.3.8. Ndërsa në nenin 27 pika 6, gërma “b” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e 13 ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”. (b) “dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”*.

III.3.9. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga ana e operatorit ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi operatori ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, pra të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e autoritetit kontraktor e të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Referuar dhe dokumentave standarde të tenderit që përcakton se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin “2.3.4. pjesë të katalogut teknik për pajisjet kompjuterike që prokurohen (të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).”, K.P.P, referuar edhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike, konstaton se, ky operator nuk ka paraqitur katalogë për të gjitha produktet e kërkuara për këtë procedurë prokurimi duke e bërë të pamundur verifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike.

Në rastin konkret operatori ekonomik “Euro Inform” sh.p.k., nuk ka paraqitur katalog për një numër të konsiderueshëm të artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarde të tenderit,



duke pasur kështu një mungesë fizike dokumentacioni. Në rastin në fjalë, Komisioni gjykon se është qartazi e dukshme, që operatori ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk vërteton se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet të ofrojë produkte në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në këtë kuptim në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar me qëllim që të bëhet krahasimi nëse malli/produkti i ofertuar plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.11. Sqarojmë se nëse ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “PC Store” sh.p.k. mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Euro Inform” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Euro Inform” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fastech” sh.p.k. për arsye se: “Ankesa 3 [...]2. 2.Pajisje Rregjistrimi Live (zeri 27):

Ky OE nuk ka paraqitur katalog qe AK të krahasoje specifikimet teknike të kerkuara me specifikimet e produktit të ofertuar, qe të plotesoje specifikimet:

*Ekrani*

*Regjistrimi*

*Integrated/Integruar 17" / 43 cm 1920 x 1200 LED-backlit LCD*

*-20 hours at 1080i using 1 TB built-in hard drive set të record at 100 Mbps AVI MJPEG*

*CPU*

*RAM*

*Memoria*

*Karta Grafike*

*Six-Core processor 3.4 GHz*

*12 MB L3 cache, 130 Ë 16 GB*

*4 total DDR3 1600 MHz RAM (non-ECC)*

*(4 GB x 4 DIMM triple-channel configuration*

*1 TB, 7200 RPM SATA 2.5" internal hard drive*

*CUDA Cores: 48, Graphics Clock (MHz): 810 MHz, Processor Clock (MHz): 1620, Memory Clock*

*(MHz): 900 (DDR3), Standard Memory Config: 1GB (DDR3), Memory Interface Ëidth: 64-bit, Memory*

*Bandëidth (GB/sec): 14.4, Standard Display Connectors: Dual Link DVI-*

*I, HDMI, VGA*

*Produkti i ofruar nuk i ploteson keto specifikime..[...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1.Në pikën 1 të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “2.3.4 *Pjese te katalogut teknik per pajisjet kompjuterike qe prokurohen (te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara).*”

III.5.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet Teknike ” të dokumentave standarte të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar :

[...]

***Pajisje Rregjistrimi Live***

| <b><i>Pajisje Rregjistrimi LIVE</i></b>       |   |
|---|---|
| <b><i>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</i></b> |   |
| <i>Karta hyres/dalese te integruara</i>       | <i>5 x Mini Recorder<br/>1 x Mini Monitor</i>         |
| <i>Hyrje</i>                                  | <i>5 x HDMI<br/>5 x SDI<br/>1 x 1/8" analog audio</i> |

|                            |  |
|----------------------------|--|
| <i>Dalje</i>               | <p><i>1 x SDI</i><br/> <i>1 x HDMI</i><br/> <i>1 x 1/8" analog audio</i></p> <p><i>Graphics Card:</i><br/> <i>1 x DVI</i><br/> <i>1 x HDMI</i></p>   |
| <i>Formati i suporutar</i> | <p><i>1080p30, 1080PsF30, 1080p29.97, 1080PsF29.97, 1080p25, 1080PsF25, 1080p24, 1080PsF24, 1080p23.98, 1080PsF23.98, 1080i60, 1080i59.94, 1080i50, 720p60, 720p59.94, 720p50, 625/25 PAL, 525/29.97 NTSC</i></p>  |
| <i>Procesimi</i>           | <p><i>Video:</i><br/> <i>10-bit, 4:2:2 (REC 601, REC 709)</i></p> <p><i>Audio:</i><br/> <i>24-bit, 48 kHz REF IN/Genlock</i></p>   |
| <i>Ekrani</i>              | <p><i>Integrated/IntegrUAR 17" / 43 cm 1920 x 1200 LED-backlit LCD</i></p>   |
| <i>Streaming</i>           | <p><i>Live HD streaming via Gigabit/100/10 built-in Ethernet</i><br/> <i>Presets in up to HD 720p</i><br/> <i>Multiple simultaneous bitrates</i><br/> <i>Mobile quality for playback over 3G on mobile devices (iPhone / Android)</i><br/> <i>Integrated live streaming to RTMP compatible servers/service</i></p> |
| <i>Regjistrimi</i>         | <p><i>~20 hours at 1080i using 1 TB built-in hard drive set to record at 100 Mbps AVI MJPEG</i></p>  |
| <i>CPU</i>                 | <p><i>Six-Core processor 3.4 GHz</i><br/> <i>12 MB L3 cache, 130  </i></p>   |
| <i>RAM</i>                 | <p><i>16 GB</i><br/> <i>4 total DDR3 1600 MHz RAM (non-ECC)</i><br/> <i>(4 GB x 4 DIMM triple-channel configuration)</i></p>   |

|                         |  |
|-------------------------|--|
| <i>Memoria</i>          | <i>1 TB, 7200 RPM SATA 2.5" internal hard drive</i>  |
| <i>Karta Grafike</i>    | <i>CUDA Cores: 48, Graphics Clock (MHz): 810 MHz, Processor Clock (MHz): 1620, Memory Clock (MHz): 900 (DDR3), Standard Memory Config: 1GB (DDR3), Memory Interface Eëidth: 64-bit, Memory Bandëidth (GB/sec): 14.4, Standard Display Connectors: Dual Link DVI-I, HDMI, VGA</i> |
| <i>Sistemi Operativ</i> | <i>Ëindoës 7 Professional (64-bit)</i>   |
| <i>GARANCIA</i>         | <i>4 Vjet</i>  |
| <i>Shenim:</i>          | <i>Per kete pajisje kerkohet te jete I perfshire instalimi dhe konfigurimi I pajisjes me pajisje te tjera si mikrofon, kompjuter dhe aparat fotografik</i>   |

III.5.3. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, për plotësimin e kërkesës së mësipërme është paraqitur pjesë katalogu për artikullin “*Pajisje Rregjistrimi Live*” në të cilin nuk janë paraqitur të gjitha specifikimet teknike të parashikuar në shtojcën përkatëse që të krahasohen specifikimet e artikullit të ofruar me artikullin e kërkuar.

III.5.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.5.5. Në nenin 23, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara*”.

III.5.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga ana e operatorit ekonomik “Fastech” sh.p.k. nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k. është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti

kontraktor, pra të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar dhe dokumentave standarde të tenderit që përcakton se “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë pjesë të katalogut teknik për pajisjet kompjuterike që prokurohen ku të përshkruhen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi në përputhje me ato të kërkuara nga AK.”, K.P.P, konstaton se katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k. për artikullin me numrin rendor ”27” konkretisht “Pajisje Rregjistrimi Live” nuk i përmban të gjitha të dhënat apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9 “Specifikimet teknike”, të dokumentave standarde të tenderit. Katalogjet - referuar edhe legjislacionit në fuqi - i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k., ka kapacitete për të ofruar produktet e kërkuar nga autoriteti kontraktor, sepse në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k. për artikullin me numrin rendor ”27” konkretisht “Pajisje Rregjistrimi Live”, nuk janë paraqitur të gjitha specifikimet teknike të parashikuar në shtojcën përkatëse, me qëllim verifikimin dhe krahasimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të artikullit të ofruar me artikullin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarde të tenderit.

III.5.7. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k., katalogu për mallrat objekt prokurimi nuk përmban të dhënat e nevojshme dhe të mjaftueshme për artikujt e prokuruar, pasi mungesa e përshkrimit të specifikimeve teknike në katalog, nuk lejon autoritetin kontraktor që të bëjë krahasimet e specifikimeve të katalogut me specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarde të tenderit, gjë kjo e cila do të shërbente si garanci për autoritetin kontraktor, për përmbushjen me sukses të objektit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Komisioni sqaron se ka qenë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Në rastin në fjalë, Komisioni gjykon se është qartazi e dukshme, që operatori ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk vërteton se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet të ofrojë produkte në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në këtë kuptim në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k. nuk ka paraqitur të gjitha specifikimet teknike për artikullin e sipërcituar me qëllim që të bëhet krahasimi nëse malli/produkti i ofertuar plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Referuar sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Fastech” sh.p.k. është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “PC Store” sh.p.k. mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Fastech” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Fastech” sh.p.k.

do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Fastech” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-22199-05-15-2019, me objekt “Blerje kompjutera dhe pajisje elektronike”, me fond limit 8.302.109 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Zeqiri” sh.p.k., “Euro Inform” sh.p.k. dhe “Fastech” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1190 Protokolli**

**Datë 02.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                      |                     |                      |                     |
|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| <b>Nënkryetar</b>    | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>        | <b>Anëtar</b>       |
| <b>Enkeleda Bega</b> | <b>Vilma Zhupaj</b> | <b>Lindita Skeja</b> | <b>Merita Zeqaj</b> |

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**